



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|---|---------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar Planned/Pradato Received/Delivered | 18.02.2022 | 2 | viti god year |
| Organ /Bjësia Organ /Jednitsa Org /Unit | Nr /Prot Br /Prot Prot No | Shtojcë Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKM8HCK | 891/2022 | | 1/9 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 38/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.890/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.73/2020 të datës 06.03.2020 e parashtruar nga ankuesit

dhe të
përfaqësuar me autorizim nga avokatët dhe me adresë:
Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit "Universitetit të Prishtinës-Hasan Prishtina" në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet Poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.73/2020 e datës 06.03.2020 e parashtruar nga ankuesit

dhe të përfaqësuar me
autorizim nga avokatët

A r s y e t i m

dhe përmes përfaqësuesit të
autorizuar nga avokatët me datë 06.03.2021 kanë parashtruar

ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit numër prot:274 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" të datës 03.02.2020 me pretendimet ankimore për kompensimin e shujtës ushqimore që nga data 18.04.2017 deri në ekzistimin e kushteve ligjore sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.03.2020, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Universiteti i Prishtinës. Më datë 15.10.2020 Universiteti i Prishtinës ka përcjell dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 14.05.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 12.01.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.890/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 15.10.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 06.03.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesve të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me numër protokollit 613/2020 e datës 06.03.2020 me shkresat e bashkangjitura; Autorizimet e datës 16.07.2019 për përfaqësimin e ankuesve; Kërkesën e ankuesve të datës 02.12.2019; Vendimin numër:274 të Këshillit Drejtues të Universitetit "Hasan Prishtina" i datës 03.02.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.03.2020; Përgjigjen e datës 15.10.2020 me numër prot:2103/2020 së bashku me akt emërimit e ankuesve të bashkangjitura në shkresat e lëndës; Njoftimin e datës 14.05.2020; Aktvendimin A.nr.890/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative të datës 27.09.2021; Përgjigjen në padi të datës 14.10.2021; Aktgjykimin A.nr.890/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative të datës 12.01.2020; Kërkesën për vendosje të datës 27.01.2022; Pasqyrën e kalkulimit të ditëve të punës të personelit Administrativ anëtarë të SBASHK të datës 10.01.2022 me numër 03/41/2; Vendimi Nr.prot:3/821 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës të datës 23.11.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa A.nr.73/2021 e datës 06.03.2020 **është e palejuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave na bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se të gjithë ankuesit janë të punësuar në administratën e Fakultetit Filologjik në kuadër të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe të njëjtit përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 06.03.2020 kanë Parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil



të Kosovës lidhur me kompensimin e shujtës ushqimore që nga data 18.04.2017 deri në ekzistimin e kushteve ligjore sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës Nr.013/2056 të datës 18.04.2017.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me vendimin Nr.prot:274 të datës 03.02.2020 ka refuzuar kërkesën e ankuesve të datës 06.12.2019 lidhur me kompensimit sipas pretendimeve ankimore të parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve, ndërsa në vendimin në fjalë këshilla juridike është dhënë si në vijim: *"Kundër këtij vendimi pala mund të ushtrojë ankesë pranë gjykatës kompetente në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit (në kopje fizike apo elektronike) të këtij vendimi."*, dhe po ashtu ankuesit e kanë sjellë një kërkesë të datës 02.12.2019 e cila është nënshkruar vetëm nga përfaqësuesi i autorizuar me pretendimin se i janë drejtuar me kërkesë edhe Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", mirëpo e njëjta shkresë nuk ka të evidentuar ndonjë shenjë apo numër protokolli që dëshmon dhe si e tillë nuk mund të provohet se e njëjta kërkesë të jetë dorëzuar apo pranuar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe se palët nuk kanë arritur ta dëshmojnë as me ndonjë provë tjetër relevante një pretendim të tillë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se përfaqësuesi i palëve ka parashtrua ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 06.03.2020 pa i shterur mjetet juridike dhe procedurat brenda organit të punësimit, veprim ky në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës neni 81 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 ku përcaktohet se: *"1. Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës"* si dhe në kundërshtim me nenin 16 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe"*.

Andaj, në mungesë të provave me shkrim përmes të cilat dëshmohet se ankuesit i kanë shterur mjete juridike brenda organit të punësimit siç përcaktohet me dispozitat ligjore të potencuara si më lartë dhe mbi këtë bazë Kolegji konstaton se nuk janë plotësuar kushtet e nevojshme ligjore për pranueshmërinë e ankesës dhe si e tillë ankesa e datës 06.03.2020 hedhet poshtë si e palejuar

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.




KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.38/2022

Flakron GASHI


Zyrtare i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqsesit të ankuesve, avokatit Sheremet dhe
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina";
- Z. Krenar Berisha, Gjykatës në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

